

# KORRUPSIONI “COPY & PASTE” NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQI

ANALIZË E RREZIQEVE DHE NDIKIMEVE  
SOCIO-EKONOMIKE NGA INVESTIMET KAPITALE  
NË BALLKANIN PERËNDIMORË DHE TURQI





Instituti Demokratik I Kosovës është degë e  
Transparency International për Kosovë

Misioni i KDI-së është mbështetja e zhvillimit të demokracisë pjesëmarrëse dhe luftës kundër korrupsionit përmes promovimit të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet dhe sektorët e shoqërisë

COPYRIGHT © 2021. Kosova Democratic Institute (KDI).

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohet në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 38,  
10000, Prishtinë, Kosovë.  
Tel.: +381 (0)38 248 038  
E-mail: info@kdi-kosova.org  
Web: www.kdi-kosova.org

**Autor:** Diana Metushi Krasniqi

**Layout dhe design:** Envinion

**Foto nga ballina:** Korab Basha, foto fituese e garës së fotografisë "Fotografo Korrupsionin", organizuar nga KDI me 09 dhjetor 2021

Publikimi i këtij raporti është bërë i mundur me përkrahjen e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS). Opinonet, të gjeturat dhe rekomandimet e shprehura në këtë raport janë përgjegjësi e KDI-së dhe jo domosdoshmërisht paraqesin qëndrimet e donatorit.

# PËRMBAJTJA

6

INTRO: RËNDËSIA E  
INVESTIMEVE KAPITALE NË  
ZHVILLIMIN E NJË SHTETI

7

LISTA E SHKURTESAVE

8-9

PËRMBLEDHJE  
EKZEKUTIVE

10-11

GJETJET KRYESORE

12

METODOLOGJIA

13-20

RREZIQET E  
KORRUPSIONIT NË  
INVESTIMET KAPITALE NË  
BALLKANIN PERËNDIMOR  
DHE TURQI

21-22

KONKLuzionET DHE  
REKOMANDIMET

23-25

FALENDËRIMET



# HYRJE: RËNDËSIA E INVESTIMEVE KAPITALE NË ZHVILLIMIN E NJË SHTETI

Investimet kapitale luajnë një rol thelbësor në zhvillimin ekonomik dhe përbëjnë një komponent dinamik efektiv të të ardhurave kombëtare. Përmasat dhe shpërndarja e tyre tregojnë rritjen apo tkurrjen e zhvillimit ekonomik, dhe lidhjen me akumulimin e kapitalit, stokun, punësimin dhe të ardhurat e shtetit. Ndërkohë që motivet e bizneseve rrotullohen rreth fitimit, motivet e përgjithshme të shoqërisë ndahen midis përfitimeve ekonomike, politike, dhe atyre sociale (OMRAN, 2018). Pra, Investimet publike nga qeveritë, qendrore dhe lokale, ndërtojnë stokun e kapitalit të një shteti.

Ekspertë të ndryshëm të çështjeve ekonomike (p.sh. BIVENS 2012, Zandi 2011, CEA 2010, CBO 2012, Woodford 2011, dhe Hall 2009) elaborojnë se shtetet, duke investuar në infrastrukturën bazë fizike (si rrugët, urat, linjat hekurudhore, aeroportet dhe shpërndarja e ujit), aktiviteteve inovative (hulumtimeve), investimeve të gjelbra (burimet e pastra të energjisë, mbrojtja e mjedisit, etj.), dhe arsim (si fillor dhe të avancuar, trajnimet profesionale, etj.) stimulojnë në rritjen e produktivitetit në vend, ofrojnë një përfitim afatgjatë të zhvillimit ekonomik, si dhe një nxitje afatshkurtër për tregun e punës, e që respektivisht përthehen në standarde më të larta jetese. Përveç përmirësimit të kualitetit të jetesës së qytetarëve, zhvillimi i projekteve të reja për ndërtimin e rrugëve dhe shkollave ndikon në punësimin e mësuesve, zhvillimin e shkencës, qarkullimin e parasë, krijimin e vendeve të punës për mbështetjen e realizimit të këtyre projekteve, rritjen e konsumit që ndikojnë në zhvillimin e biznesit, etj. Të gjitha këto në terme të shkurta ndikojnë në mënyrë zinxhimore në krijimin e vendeve të reja të punës. Për më shumë, këto ekspertiza theksojnë se investimi në infrastrukturë ka të bëjë me mbështetjen më efikase fiskale që mund t'i ofrohet një ekonomie në depresion - një gjetje e mbështetur nga pothuajse të gjitha modelet dhe parashikimet makroekonomike.

Ndërkohë, (MAURO 1997) analizat të regresionit ekonomik tregojnë se korrupsioni është ngushtë i lidhur me nivelin e investimeve dhe rritjen ekonomike, pra sa më shumë korrupsion, aq më pak investime dhe më pak rritje ekonomike. (Lin & Zhang 2009) Korrupsioni në investimet kapitale ka një ndikim negativ direkt në rishpërndarjen e të ardhurave, shpenzimet e qeverisë për infrastrukturën, stimujt e bizneseve për të investuar dhe nxitjen e punëtorëve për të ofruar fuqi punëtore.

Në çdo shoqëri, ekzistojnë ligje dhe rregullore për t'i shërbyer objektivave shoqërore dhe për të mbrojtur interesin publik, të tilla si kodet e ndërtimit, kontrollat mjedisore, ligjet e trafikut dhe rregulloret e kujdeshme bankare. (Myint 2000) Shkelja e këtyre ligjeve për përfitime ekonomike përmes mjeteve korruptive mund të shkaktojë dëme serioze sociale.

Prandaj (OECD 2016), në këtë drejtim, shmangia e kapjes në projektet e investimeve publike është thelbësore për të maksimizuar përfitimet e tyre ekonomike dhe sociale.

Në ndërkohë, hulumtime të ndryshme ngritin shqetësime serioze lidhur me integritetin e investimeve në Ballkanin Perëndimorë (CDI, 2021) dhe nivelin e lartë të korrupsionit në këto shtete (U4: BAK, 2019 & DURİ, 2021).

Përveç humbjes së parasë publike, e cila ndikon direkt në zhvillimin ekonomik duke pamundësuar investime të reja shtesë, në shumë raste të ndryshme investimet kapitale të dyshuara për korrupsion kanë rezultuar direkt në mirëqenien e qytetarëve të Ballkanit Perëndimorë dhe Turqisë.



# LISTA E SHKURTESAVE

- AK** Autoriteti Kontraktues
- AKK** Agjencia Kundër Korrupsionit
- AQP** Agjencia Qendrore e Prokurimit
- BE** Bashkimi Evropian
- BH** Bosnja dhe Hercegovina
- BP** Ballkani Perëndimor
- CDI** Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim
- COE** Këshilli i Evropës
- FMN** Fondi Monetar Ndërkombëtar
- CPI** Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit
- KDI** Instituti Demokratik i Kosovës
- KE** Komisioni Evropian
- KRPP** Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
- LPP** Ligji për Prokurim Publik
- OE** Operator Ekonomik
- OECD** Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
- OSHC** Organizata të Shoqërisë Civile
- OSHP** Organi Shqyrtues i Prokurimit
- PBB** Prodhimi i Brendshëm Bruto
- TI** Transparency International
- U4** Qendra për resurse kundër korrupsionit
- ZKA** Zyra Kombëtare e Auditimit



# PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Prokurimet publike kanë një pjesëmarrje të dukshme prej 7 deri në 12% në GDP-të e vendeve të Ballkanit Perëndimor<sup>1</sup>, përderisa rreth 40% të buxheteve vjetore shtetërore<sup>2</sup> të këtyre shteteve shpenzohen në investime kapitale. Duke pasur parasysh vlerën e madhe të parasë që mund të futet në qarkullim në ekonomitë vendore apo rrezikun nga dështimet, investimet kapitale duhet të trajtohen me një kujdes të veçantë nga qeveritë, respektivisht institucionet përkatëse, që të sigurohet parimi i arritjes së **"vlerës për paranë"** dhe që fitimi nga investimet u kthehet aksionareve të vërtetë, e që janë vet taksapaguesit e këtyre shteteve.

Rreziqet e korrupsionit në investime kapitale llogaritet të jenë 20-25% të vlerës së kontratave publike (OECD, 2015b), dhe duke ndikuar në uljen e produktivitetit të investimeve në infrastrukturë, duke stimuluar "elefantët e bardhë"<sup>3</sup>, përkatësisht infrastrukturë që nuk i nevojitet askujt. Po ashtu rreziku shpërfaqet edhe tek zhvillimi i projekteve shumë më të mëdha.

Në vazhdim, me qëllim të stimulimit të një tranzicioni më të shpejtë dhe përmbajtjesor, dhe me qëllim të zbutjeve të tensioneve multi-nacionale në rajonin e Ballkanit perëndimor, në vitin 1999, BE-ja nisi Procesin e Stabilizim-Asociimit, një kornizë për marrëdhëniet midis BE-së dhe vendeve në rajon, dhe Paktin e Stabilitetit, një iniciativë më e gjerë që përfshin të gjithë aktorët kryesorë ndërkombëtarë. Me qëllim të mbështetjes së këtij procesi BE kishte zhvilluar mekanizmin e Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit<sup>4</sup>. Fillimisht, në mars të vitit 2021, përmes Instrumentit për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III) BE kishte ndarë rreth 14 miliardë dollarë për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë

për periudhën 2021 – 2027, por që në tetor 2021, kishte bërë një zotim të ndajë rreth 30 miliardë euro për Ballkanin Perëndimor për të ndihmuar zhvillimin dhe për t'i shtyrë vendet e këtij rajoni drejt anëtarësimit të tyre të plotë në BE<sup>5</sup>.

Paketa prej 30 miliardë eurosh mund të përdoret për investime në energji, rrjete dixhitale, rrugë dhe sektorë të tjerë, ndërkohë që këto projekte do të realizohen nga qeveritë e shteteve përfituese. Këto projekte realizohen përmes politikave për shpenzimin e parasë publike si përmes ligjeve përkatëse specifike për investime strategjike me interes kombëtar, partneritete publiko private dhe prokurimeve publike. Në vazhdim, në nëntor 2020, shtetet e Ballkanit Perëndimor kishin nënshkruar deklaratën e Sofjes për Agjendën e Gjelbër, me ç' rast këto shtete u zotuan për disa veprime mbi klimën, energjinë dhe lëvizshmërinë, ekonominë rrethore, eliminimin e ndotjeve mjedisore, bujqësinë e qëndrueshme dhe prodhimin e ushqimit, si dhe biodiversitetin<sup>6</sup>.

Përderisa po flasim për investime tejet të larta të destinuara për zhvillimin e rajonit, analiza ngrit shqetësime serioze me keq-menaxhimin e projekteve kapitale në rajon<sup>7</sup> dhe rreziqet nga korrupsioni, të cilat përfundimisht rezultojnë në një ndikim pothuajse të parikuperueshëm në mjedis<sup>8</sup> dhe ndikim të madh negativ në mirëqenien sociale<sup>9</sup>, dhe të cilat nuk arrijnë të bëjnë një stimulim të një zhvillimi të mirëfilltë ekonomik<sup>10</sup>.

Analiza ka gjetur se, në të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, ekziston bazë ligjore e mjaftueshme për të siguruar një proces të drejtë të prokurimeve publike,

1 "Raporti i vlerësimit krahasues mbi sistemet e prokurimit publik në Bosnjë dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut, Malin e zi, Kosovë dhe Serbi" 2019 Balkan Tender Watch

2 Corruption Perception Index 2020, Transparency International, <https://www.transparency.org/en/cpi/2020/index/nzl>

3 A mund të vrasin Elefantët e Bardhë? Pasojat e paqëndrueshmërisë të zhvillimit të infrastrukturës në Peru, Bancalari, A. 2019, e qasshme në: <https://www.lse.ac.uk/economics/Assets/Documents/job-market-candidates-2019-2020/BancalariJMP.pdf>

4 European Commission: The Instrument for Pre-accession Assistance (IPA): [https://ec.europa.eu/regional\\_policy/en/funding/ipa/](https://ec.europa.eu/regional_policy/en/funding/ipa/)

5 European Council, Brdo Declaration, 6 October 2021: <https://www.consilium.europa.eu/media/52280/brdo-declaration-6-october-2021-en.pdf>

6 SOFIA DECLARATION ON THE GREEN AGENDA FOR THE WESTERN BALKANS (2020): <https://berlinprocess.info/wp-content/uploads/2021/02/Leaders-Declaration-on-the-Green-Agenda-for-the-WB.pdf>

7 „Integrity Compliance in Infrastructure Projects”, Civil Society Forum (prepared by Cooperation and Development Institute), 2021

8 Industria e shkatërrimit, ÇOHU 2019

9 [Varrosja e Lepencit](#), KDI 2020

10 "Fokusi i politikave të Ballkanit Perëndimor duhet të kthehet drejt adresimit të kufizimeve kryesore strukturore për krijimin e vendeve të punës dhe transformimin ekonomik" Banka Botërore (2021), Western Balkans Regular Economic Report: Fall 2021: <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkans-regular-economic-report>

që do të stimulonte zhvillimin ekonomik përmes këtij aktiviteti publik, dhe do të siguronte ruajtjen e vlerave të publike dhe shoqërore.

Investimet kapitale përveç që janë të cenueshme ndaj korrupsionit, ato përcillen me mbikëqyrje të dobët në zbatim që rrezikon për pasojë afatgjate në shoqëri dhe mjedis. Është e evidente se mosrespektimi i detyrimeve të përgjithshme vlen edhe për kontratat e partneritetit publiko privat dhe koncesionet.

Përderisa fondet më të mëdha janë të dedikuara për "investime strategjike", shohim se i gjithë rajoni ballafaqohet me problemin kronik të kapjes së shtetit mu në këtë fushë në emër të "së mirës së përgjithshme" dhe përmbushjes së detyrimeve në rrugën drejt BE<sup>11</sup>, por që në thelb gjenerojnë përfitime për "kompani të përveçme" duke anashkuar ligjet ekzistuese apo hartuar ligje specifike që u përshtaten investitorëve.

Një shqetësim bazë ndërlidhet me përfshirjen e publikut në këto procese. Ndonëse shtetet gjegjëse posedojnë bazat ligjore për vlerësimin e ndikimit në mjedis, përmes të cilave institucionet obligohen të konsultojnë qytetarët mbi investimet kapitale, këto dispozita janë neglizhuar në vazhdimësi ose janë përmbushur vetëm sa për "sy e faqe", duke e anashkuar qytetarin në emër të "së mirës së përgjithshme" përmes ligjeve apostafat për investimin në fjalë.

Për më shumë, në të gjitha shtetet dhe të gjitha investimet kapitale të vlerës së madhe, ndonëse interesi publik është tejet i madh, përveç mos përfshirjes së qytetarëve në procesin e planifikimit dhe mbikëqyrjes, transparenca nga qeveritë përkatëse është pothuajse jo ekzistuese.

Ndonëse raporti nuk arrin të analizoj në tërësi të gjitha fazat në mënyrë të detajuar për rastet e ilustruara në vijim, analiza në fjalë shpërfaq shqetësim serioz për dështimin e trekëndëshit të ndërvarësisë demokratike, ku qeveritë dhe bizneset janë tejet të afërta në një "trekëndësh të hekurt"<sup>12</sup> të deformuar<sup>13</sup> duke lënë të nën përfaqësuar shtyllën e tretë të demokracisë - qytetarin<sup>14</sup>.

11 P.sh. shkeljet ligjore lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve të cilat në emër të energjisë së ripërtrishme kishin ndikuar negativisht në shoqëri, mjedis dhe ekonomitë familjare duke ulur rendimentin bujqësor.


12 "Në politikën e Shteteve të Bashkuara, "trekëndëshi i hekurt" përfshin marrëdhëniet e politikëbërjes midis kongresit (parlamentit), qeverisë dhe grupeve të interesit", 1981 Adams, G., The Politics of Defense Contracting: The Iron Triangle, Taylor & Francis 2020, 466 pp

13 Në hartimin e ligjeve speciale për investime përmes koncesioneve, parlamenti rreshtohet me qeverinë dhe jo përfaqësimin e interesit publik

14 Bruce M. Russett and John R. O'Neal, Triangulating Peace: Democracy, Interdependence, and International Organizations, W. W. Norton, 2001, 305 pp



# RREZIQET NGA INVESTIMET KAPITALE



- Kontratat për rrjetet e ujërave të zeza janë ndotësit kryesorë të Lumenjve
- Ujërat e zeza dhe hidrocentralet kanë ndikim direkt në florë dhe faunë
- Hidrocentralet kanë ndikuar në shpërfytyrimin e mjedisit
- Rritja e sëmundjeve që derivojnë nga ndotjet mjedisore
- Ndikimi në rendimentin bujqësor rreth lumenjëve dhe kualitetin e produkteve
- Ndikim emocional në vështirësitë e sigurimit të ujit të pijshëm
- Mohimi i të drejtës ligjore për të qenë pjesë e vendimmarrjes dhe proceseve zhvillimore me interes publik
- Vështirësitë në qasjen e NVM në kontratat publike dhe mjetet tjera stimuluese
- Mungesa e zbatimit të ligjit, llogaridhënies dhe transparencës
- Kosto e menaxhimit/riparimit të dëmit infrastrukturor dhe mjedisor, rritjen e barrës sociale dhe rritjen e kostos shëndetësore
- Humbja direkte e parasë publike në afera korruptive
- Promovimi i Korporatokracisë<sup>15</sup> duke favorizuar biznese të caktuara të afërta me politikën përmes kriterëve të përshtatura, ligjeve specifike apo kontratave sekrete duke mos arritur stimulimin e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik por krijimin e plutokratëve<sup>16</sup> në rajon.

<sup>15</sup> Korporatokracia: për të mos u ngatërruar me Korporatizmin, është një term i përdorur si një sistem ekonomik dhe politik i kontrolluar nga korporatat ose interesat e korporatave. (definitions.net)

<sup>16</sup> Plutokracia: Në një plutokraci sundojnë të pasurit, por jo gjithmonë duke qenë drejtues të zgjedhur të qeverisë. Në shumë raste, të pasurit mund të ndikojnë te vendimmarrësit me mjete të ligjshme dhe të paligjshme, të tilla si lobimi, ryshfeti dhe financimi i fushatave zgjedhore. (investinganswers.com)



# METODOLOGJIA

Investimet kapitale në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi në përgjithësi trajtohen vetëm nga perspektiva e zhvillimit të një infrastrukture konform standardeve evropiane, strategjive rajonale dhe sipërfaqësisht përfitimeve ekonomike. Megjithatë, apo nuk trajtohen apo analizohen se cila do të ishte përqindja e shtytjes së zhvillimit ekonomik vendor dhe cilat janë rreziqet anësore gjatë implementimit të tyre. Për më shumë nuk bëhet një analizë e kostos oportune në këto investime si nga aspekti ekonomik, shoqëror apo mjedisor. Në përgjithësi, kur flitet për investimet publike mendohet vetëm në kontratat publike për ndërtim të

rrugëve e shkollave përmes prokurimit publik, por jo dhe partneriteteve publiko private dhe koncesioneve ku ofrohen lehtësime në shfrytëzimin e resurseve publike për një të mirë publike, e cila do të rriste vlerat demokratike të një vendi. Në vazhdim investimet kapitale trajtohen vetëm nga perspektiva e humbjes direkte të parasë publike përmes aferave korruptive, por jo edhe për nga humbjet nga efektet anësore që ato shkaktojnë në shoqëri, shëndet, mjedis dhe zhvillim ekonomik.

## Analiza tenton të ngritë tre pyetje:

- 1 Cilat investime kanë ndikimin më të madh në mjedis dhe shoqëri dhe humbje të parasë publike?
- 2 A ka një bazë ligjore për të menaxhuar rrezikun nga këto investime?
- 3 Çfarë mund të bëhet që të përmirësohet kjo situatë?

Analiza bazohet në disa burime të informatës si: Raste konkrete të analizuar për dëme mjedisore dhe shoqërore dhe afera korruptive, kontribute nga shoqëria civile e rajonit në raste specifike të analizuar, analiza dhe publikime paraprake nga organizata të shoqërisë civile, media, hulumtime universitare apo shkencore, raporte dhe të dhëna nga BE/KE, ligje dhe dokumente zyrtare të shteteve përkatëse dhe literaturë të specializuar në temën përkatëse,

si dhe organizimi i një punëtorie me mbi 20 pjesëmarrës nga rajoni, me qëllim të ndarjes së eksperiencave dhe rekomandimeve të përbashkëta për përmirësimin e kualitetit të investimeve kapitale në rajon.

# RREZIQET E KORRUPSIONIT NË INVESTIMET KAPITALE NË BALLKANIN PERËNDIMOR DHE TURQI

## HUMBJA E PARASË PUBLIKE, RREZIKIMI I SHËNDETIT DHE MIRËQENIES, DEGRADIMI MJEDISOR DHE STIMULIMI I MONOPOLEVE

### 1 Investimet strategjike në energji të ripërtrishme dhe ndikimet në shoqëri dhe mjedis:

Në vitin 2003 shtetet e Ballkanit Perëndimor kishin nënshkruar traktatin e Vienës, me ç' rast ato ishin zotuar se, në drejtim të mbrojtjes së mjedisit përmes uljet së përdorimit të linjitet për gjenerimin e energjisë, deri në vitin 2020 ato do të investonin që 20% e bruto prodhimit vendor të të vinte nga burimet e ripërtrishme.

Në të gjitha shtetet e rajonit, investimi në energji të ripërtrishme ishte kategorizuar si strategji shtetërore, dhe ishin adaptuar politika nxitëse për investime në këtë sektor. Këto investime do të bëheshin nga sektori privat përmes skemave të garantimit të shitjes "Feed-In-Tariff" dhe në disa raste edhe me grante qeveritare. Duke qenë se energjia e ripërtrishme ishte një politikë e shtyrë nga Bashkimi Evropian dhe ofronte shitje të garantuar, investitorët e këtij sektori kishin gjetur mbështetje financiare edhe tek

institucionet bankare vendore dhe evropiane. Në rajon, fokusi i prodhimit të energjisë së ripërtrishme ishte përmes shfrytëzimit të resurseve ujore, solare, ajrit dhe biomasës.

Për shkak se investimi në hidroenergji ishte më i shpejti dhe më i liri nga opsionet, dhe nën pretekstin se uji nuk po zhdukej por vetëm përdorej edhe për një qëllim shtesë, në Ballkanin Perëndimor filluan të lulëzonin hidrocentralet e vogla, të cilat për dallim nga hidrocentralet e mëdha, rritjen e kapacitetit prodhues do ta bënin përmes futjes tuba të një pjese të madhe të ujit nga lumi për një gjatësi të caktuar, dhe jo përmes pendave akumuluese.





Por në këtë proces qeveritë përkatëse kishin dështuar të konsideronin të gjitha rreziqet e mundshme që mund të rrjedhin nga futja e lumit në tuba. Për më shumë, të gjitha shtetet e rajonit kishin dështuar të përfshinin qytetarët në këtë proces, të konsultoheshin dhe merrnin aprovimin e tyre siç u takonin me kushtetutat e shteteve përkatëse. Përgjatë lumenjve të Ballkanit filluan të ndërtoheshin hidrocentrale të vogla brenda parqeve kombëtare, përskaaj tokave bujqësore, fshatrave të ndryshme të cilave po u rrezikohej furnizimi me ujë të pijshëm, etj<sup>17</sup>. Pas ndërtimit të hidrocentraleve të para, dhe daljes në pah të rreziqeve për bujqësinë, ekonomitë familjare dhe florën e faunën, pakënaqësitë dhe rezistenca e qytetarëve të rajonit kundër këtyre investimeve kishte filluar që nga viti 2012 e deri më sot. Për më shumë, shqetësime të ndryshme ishin ngritur lidhur me efikasitetin e këtyre investimeve<sup>18</sup>.

Në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë<sup>19</sup> dhe Kosovë<sup>20</sup> qytetarët dhe shoqëria civile kishin ngritur zërin lidhur me degradimet mjedisore, rrezikimin e rendimentit

bujqësor, respektivisht ekonomitë familjare, dhe rrezikimin e furnizimit me ujë të pijshëm. Po ashtu ishin ngritur shqetësime lidhur me korrupsion të mundëm me lejet e ndryshme gjatë procesit të ndërtimit dhe funksionalizimit të hidrocentraleve të cilat binin ndesh me ligjet për mbrojtjen e mjedisit. Në Kosovë, në një rast specifike ishin ngritur shqetësime edhe lidhur me konfliktin në shfrytëzimin e burimeve ujore në pellgun e lumit Lepenc, veprim i qeverisë i cili ose rrezikon shuarjen e projektit madhor nga i cili do të përfitonin ujë të pijshëm rreth 550 mijë banorë të Kosovës, ose humbjen e dhjetëra milion eurove nga detyrimet përmes lejeve të dhëna dhe skemës së "Feed-In-Tariff" të garantuar për hidrocentralet në këtë territor<sup>21</sup>.

Megjithatë, në Mal të Zi<sup>22</sup>, Maqedoni të Veriut dhe Serbi, ndonëse reagimi i qytetarëve ishte i njejtë dhe rreziqet nga degradimet ishin identike me ato të Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës dhe Kosovës, raportet hulumtuese kishin identifikuar lidhje të larta politike, nepotizëm e kapje e shtetit në sektorin e energjisë, e me një theks të lartë hidro energji<sup>23</sup>.

**“Në gjithë rajonin, për shkak të kategorizimit si investim strategjik me interes publik/kombëtar, në projektet e ndërtimit të hidrocentraleve ishin bërë anashkalime të dispozitave ligjore për ujërat, pajisjet me lejet e nevojshme, pjesëmarrje të publikut, si dhe të gjitha këto në mungesë të transparencës<sup>24</sup>.”**

Pas ngritjes së problemeve të shumta shoqërore, ekonomike e mjedisore në nivel global lidhur me ndërtimin e hidrocentraleve, fokusi i sigurimit të energjisë së ripërtrishme në nivel të BE<sup>25</sup> kishte ndërruar ku 77% e

energjisë do të sigurohej nga ajri dhe dielli (solar), 13% nga gazi natyral, dhe pjesa e mbetur nga burime të tjera. Megjithatë, gjatë këtij hulumtimi nuk ishte gjetur asnjë studim në nivele shtetërore apo rajonal për pasojat e

17 [Small Hydro: Harmful to everyone - except investors, 2018 Heinrich Böll Foundation](#)  
 18 [Pasojat e ndërtimit të hidrocentraleve të vegjël në BiH \(3\): hidrocentralet e vogla austriake, të bashkëfinancuara nga qytetarët e BiH, funksionojnë me humbje, 2020 Center for Environment, Banja Luka, BiH](#)  
 19 (1) [A tale of two communities successfully resisting the Balkan hydropower tsunami, CEE Bankwatch Network](#); (2) Transparency International Bosnia and Herzegovina  
 20 Ujë pak e nevoja shumë, 2020 KDI  
 21 Ibid  
 22 [Kapja e shtetit në sektorin e energjisë në Mal të Zi: Hidrocentralet e vogla sjellin fitime të mëdha, 2018 MANS](#)  
 23 (1) [Western Balkans hydropower: Who Pays, who profits?, 2019 CEE Bankwatch Network](#); (2) KDI Focus group 04-05 september 2021  
 24 Ibid  
 25 EU Green Deal 2019



mundshme<sup>26</sup> mjedisore në florë dhe faunë nga mbulimi i qindra hektarëve me panele solare<sup>27</sup>, ndikimi në zona të mbrojtura<sup>28</sup> dhe ndikimi në agrikulturë, duke pasur parasysh se ky segment ekonomik është pjesë e strategjive zhvillimore të të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor.

Por hidrocentralet nuk janë i vetmi sulmues i lumenjve të Ballkanit, me një ndikim të drejtë për drejtë në mirëqenien e qytetarëve.

## 2 Investimet publike në ndotjen e ujërave të pastër me ujëra të ndotura:

Në vitin 2010, Qeveria e Kosovës kishte investuar në ndërtimin e parkut të biznesit në Drenas, i cili do të ofronte një infrastrukturë të mirëfilltë për mbështetjen e bizneseve në Kosovë. Ndonëse i promovuar si një tregim suksesi, mos përfundimi i kanalit të ujërave të zeza të këtij parku<sup>29</sup> kishte rezultuar që ujërat e zeza industriale të derdheshin në përroskën dhe fushat përskaaj parkut duke bërë që mbetjet kimike të kontaminonin ujërat nëntokësore dhe që fshati përskaaj të humbte qasjen në ujë të pijshëm e që kishte rritur shpenzimet familjare me mbi 150€ në muaj vetëm për furnizim me këtë produkt esencial<sup>30</sup>.

Ndotje të ngjashme të ujërave kishin ndodhur edhe në Maqedoninë e Veriut<sup>31</sup> ku pellgu i mbejtjeve të metaleve të rënda nga Miniera e Sasës, kishte ndikuar në sedimentin e

liqenit të Kamenit duke ndikuar negativisht në ekosistemet përreth saj. Ndërsa në rastin e Shqipërisë raportohet për ndotjen e lumenjve nga derdhjet e pa trajtuara të ujërave të zeza organike dhe industriale në mënyrë të pa trajtuar, me një theks të mbetjeve nga prodhimet e vajrave, të cilat kishin ndikuar në faunën e lumenjve<sup>32</sup>.

Problemi i derdhjes së ujërave të zeza organike dhe industriale në lumenj është i theksuar në gjithë Ballkanin Perëndimor. Ndonëse mbulueshmëria me rrjete të ujërave të zeza varion nga 47% deri në 90% të vendbanimeve në shtetet e rajonit, raportet shpërfaqin shqetësime se vetëm 1 – 15% të ujërave të zeza në nivel rajonal trajtohen para derdhjes në lumenj<sup>33</sup>, duke ndikuar në kontaminimin e ujërave nëntokësore dhe përmbajtjes së tokës bujqësore në pjesët rurale<sup>34</sup>. Ndotjet e tilla përveç rritjes së shpenzimeve familjare për furnizim me ujë të pijshëm, ndrisin shqetësime lidhur me implikimet shëndetësore të qytetarëve të cilët janë në kontakt të vazhdueshëm me këto ujëra<sup>35</sup>. Analiza e kornizave ekzistuese ligjore për vlerësimin e ndikimit mjedisor nga ndërtimi i rrjeteve të ujërave të zeza tregon se shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor, ndonëse posedojnë ligje për mbrojtjen e ujërave, nuk posedojnë mekanizma obligues për vlerësimin e rreziqeve para ndërtimit të tyre, duke rrezikuar kualitetin e ujërave përmes këtij investimi kapital.

26 [Lambert Q, Bischoff A, Cluchier A, Cuffe S, and Gros R: Institut M'editerran 'een de Biodiversit'e et d'Ecologie Marine et Continentale: Effects of solar parks on soil quality, CO2 effluxes and vegetation under Mediterranean climate, ECO-MED, INRAE "Ile-de-France-Versailles-Grignon; Published 2021 Jun 6](#)  
 27 [Choi Chong Seok, Cagle Alexander E., Macknick Jordan, Bloom Dellena E., Caplan Joshua S., Ravi Sujith; Frontiers in Environmental Science; Effects of Revegetation on Soil Physical and Chemical Properties in Solar Photovoltaic Infrastructure; Published 2020 Aug 11](#)  
 28 [Solar energy development and land cover change; Rebecca R. Hernandez, Madison K. Hoffacker, Michelle L. Murphy-Mariscal, Grace C. Wu, Michael F. Allen; Proceedings of the National Academy of Sciences Nov 2015, 112 \(44\) 13579-13584; DOI: 10.1073/pnas.1517656112](#)  
 29 Kanali ishte përfunduar në vitin 2019 pas ngritjes së shqetësimeve për ndikimin mjedisor dhe social nga Kosova Democratic Institute në vitin 2017.  
 30 Investimet e Arnuaara 2017, Kosova Democratic Institute  
 31 Vrhovnik, Petra & Rogan Šmuc, Nastja & Dolenc, Tadej & Serafimovski, Todor & Tasev, Goran & Dolenc, Matej. (2011). Geochemical investigation of Sasa tailings dam material and its influence on the Lake Kalimanci surficial sediments (Republic of Macedonia) - Preliminary study. Geologija. 54.4, 183-190. 10.5474/geologija.2011.013.  
 32 Bani, Aida & Rroco, Evan & Malltezi, Jamarbër & Shallari, Seit & Libohova, Zamir & Sinaj, Sokrat & Qafoku, Nikolla. (2018). Water quality in Albania: An overview of sources of contamination and controlling factors.  
 33 The Swedish International Development Cooperation Agency, individual country factsheets (as of 2/12/2021)  
 34 (1) Belis CA, Pisoni E, Degraeuwe B, et al. Urban pollution in the Danube and Western Balkans regions: The impact of major PM2.5 sources. Environ Int. 2019;133(Pt A):105158. doi:10.1016/j.envint.2019.105158; (2) Bajoriniene A, Leitmeyer KC, Struelens MJ, Kokki MH; Observers and Alternate Observers to the ECDC National Microbiology Focal Points in Western Balkan Countries. Investing in Public Health Microbiology Laboratories in Western Balkan Countries Enhances Health Security From Communicable Disease Threats in Europe. Front Public Health. 2019;7:8. Published 2019 Feb 4. doi:10.3389/fpubh.2019.00008; (3) Lumenjtë e zi të Kosovës, 2020, Kosova Democratic Institute  
 35 Ibid







**Një fakt shqetësues është që gjatë analizimit të ligjeve për vlerësimin e ndikimit në mjedis, në asnjërin legjislacion të shteteve përkatëse nuk kërkohet që të bëhet një vlerësim i ndikimit mjedisor për projektet e ndërtimit të rrjeteve të kanalizimeve (ujërave të zeza organike), ndonëse humltime të vazhdueshme në secilin nga këto shtete identifikojnë mu këtë investim si ndotësin më të madh të lumenjve.”**

Një rast më alarmant lidhur me rrezikun për kontaminim të ujit dhe rrezikim të shëndetit të qytetarëve është ai i minierës së operuar nga Rio Tinto në Luginën e Jadarit, në Serbi, ku sipas planit të punës, përveç derdhjes së mbi 90 milion tonëve të mbetjeve sterile nga mihja në lum, ishte paraparë të bëhej një deponi ku mbi 7,000 ton arsenik do të derdheshin në një afërsi të lumit, e që një devijim i saj dhe dalje në lum do të rrezikonte seriozisht shëndetin<sup>36</sup> e qytetarëve të dy shteteve Serbi dhe Bosnje dhe Hercegovinë<sup>37</sup>.

### 3 Projektet “me rëndësi kombëtare” vetëm për përfitime të kompanive

Siç duket, korrupsioni dhe përfitimet nga zhvillimet urbanistike janë një rrezik i theksuar në investimet kapitale në gjithë Ballkanin Perëndimorë dhe Turqi<sup>38</sup>.

Përkundër protestave të vazhdueshme të qytetarëve të Loznicsës (Serbi) kundër operimit të minierës në Luginën e Jadar nga Rio Tinto, në emër të mbështetjes së zhvillimit ekonomik, në rastin konkret Qeveria e Serbisë përveç që kishte shkelur dispozitat ligjore për planifikim dhe ndërtim, miniera, bujqësi, mbrojtjen e pyjeve e vlerësimin strategjik të ndikimit në mjedis, ajo kishte shpenzuar mbi 450 milion euro në infrastrukturën ndihmëse (rrugë, gazsjellës,

hekurudhë dhe shpronësime) në favor të operatorit ekonomik<sup>39</sup>. Vendime të dyshimta favorizuese për industrinë mihëse ishin identifikuar edhe në Kosovë, ku në vitin 2017 qeveria kishte anuluar vendimin për shpalljen e zonës së Gadimës<sup>40</sup> si zonë e mbrojtur me interes kombëtar dhe gjeoturistik, duke e lënë atë në rrezik nga gurthyesi, i cili përveç degradimit mjedisor duke mos respektuar obligimet ligjore lidhur me standardet e mihjes dhe kultivimin e zonës, po ashtu kishte përfituar kontrata publike mbi 8 milion euro në ndërtimin e rrugëve publike, e të gjitha këto kishin ngritur dyshimet për korrupsion dhe favorizim<sup>41</sup>.

Në vazhdim, për të përmbushur nevojat e ndërtimitarisë të cilat kanë marr një hov të madh në Kosovë si nga investimet publike po ashtu edhe nga sektori privat, në mënyrë të pamëshirshme mbi 200 gurëthyes po shkatërrojnë pyjet e Kosovës duke rrezikuar shëndetin dhe mirëqenien e banorëve përsëj përmes ndotjes akustike, pluhurit dhe trafikut të shpeshtë të kamionëve të mëdhenj<sup>42</sup>. Ndonëse Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale në Kosovë kishte deponuar mbi 200 kallëzime penale në prokuroritë themelore përkatëse, dhe një numër i konsiderueshëm i tyre ishin ndaj institucioneve publike për lejimin e shfrytëzimit të gurit ilegal në projektet publike për ndërtimin e rrugëve si në nivel lokal, po ashtu edhe atë qendror përkundëjt dispozitave ligjore në dispozicion për këtë fushë, fatqësisht numri më i madh i këtyre kallëzimeve nuk ishin procesuar<sup>43</sup>. Hulmimet tregojnë se një nga arsytet e mos trajtimit janë lidhjet politike ndërmjet operatorëve të industrisë mihëse dhe shtresës së lartë politike<sup>44</sup>.

36 Arsenic, Organizata Botërore e Shëndetësisë  
 37 PAKT Srbija  
 38 Ekzaminimi i kapjes së shtetit: Ndikimi i padrejtë në ligjërbërjen dhe gjyqësorin në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, 2020 Transparency International  
 39 Ibid  
 40 Shpella e Gadimes, destinacion turistik i pazëvendësueshëm!, Agjencioni për mbrojtjen e mjedisit në Kosovë  
 41 Pyje për asfalt, 2020 Kosova Democratic Institute  
 42 Pyje për Asfalt, 2020 Kosova Democratic Institute  
 43 Amnistimi i degraduesëve të mjedisit, 2021 ÇOHU  
 44 Kapja e shtetit në Kosovë: Ekonomia politike e zhavorrit



Një tjetër kontratë strategjike publike për ndërtimin e autostradës “Arbën Xhaferi” e cila do të ndërlidhte Kosovën me Maqedoninë e veriut, përveç që ishte zhvilluar në mungesë të plotë të transparencës publike, dhe përkundëjt reagimeve të publikut të mos nënshkruhej në prag të ndërrimit të qeverive, për shkak të neglizhencës kronike të qeverisë i kishte kushtuar qytetarëve 53 milion euro dëmshpërblim për kompaninë implementuese<sup>45</sup> dhe kishte ngritur dyshime për korrupsion. Edhe pse deri më sot janë ndërruar tre qeveri, aneks kontrata se çka përfshinë ky dëmshpërblim që potencialisht i kushtoi Kosovës rreth 4,000 vende të reja të punës<sup>46</sup> mbetet e mbyllur për publikun.

Dyshime për lidhje politike dhe keqpërdorime të parasë publike janë ndritur edhe lidhur me proceset e shpronësimit të traseve për ndërtimin e rrugëve dhe autostradave në Kosovë, duke vënë në pah që funksionarë të lartë politik kishin blerë toka me çmime tejet të ulëta në këto hapësira, e të cilat ishin shpronësuar nga shteti me vlera mijëra herë më të larta. Për më shumë, edhe përkundëjt që këto shpenzime kanë të bëjnë me shpenzime publike, listat e përfituesve nga këto veprime ende mbeten të mbyllura për publikun përkundëjt dispozitave ligjore për të drejtën mbi informacionin publik<sup>47</sup>. Në vitin 2018, qeveria e atëhershme kishte marr vendim se për ndërtimin e autostradës Prishtinë-Gjilan, do të kontraktonte kompani vendore, dhe që kjo autostradë do t'i kushtonte qytetarit të Kosovës për gjysmë më lirë<sup>48</sup> se dy autostradat e më parme të implementuara nga kompani ndërkombëtare<sup>49</sup>. Megjithatë, në këtë “sukses” të promovuar të qeverisë, mediat vendore (Kallxo.com 2021) kishin raportuar për përfitimet e kompanive të zyrtarëve të ministrisë së infrastrukturës në pushtet nga nën kontraktimet në këtë projekt<sup>50</sup>. Për më shumë, në 2021 Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë kishte konfirmuar aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës katër zyrtarëve të Ministrisë së Infrastrukturës lidhur me akuzat për keqpërdorime në tenderin për autostradën e Gjilanit, ndërsa në proces ngritën dyshime

edhe për përfshirjen dhe ushtrimin e ndikimit nga Ministri i atëhershëm i Infrastrukturës<sup>51</sup>.

Kapja e shtetit në sektorin e investimeve përmes koncesioneve the partneritetit publik ishte identifikuar si një problem madhor edhe në Shqipëri. Që nga viti 2004 deri në vitin 2019 në Shqipëri ishin dhënë 219 kontrata koncesionare, ku rreth 87% ishin për shfrytëzimin e burimeve natyrore me 95% të tyre për HEC në vlerë të afër 3.2 miliard euro<sup>52</sup>. Ndonëse kur kishte filluar ky proces, nga opozita e atëhershme (PS) ishte kritikuar për mungesë të transparencës dhe për shumë gabime dhe rreziqe të korrupsionit, pas ardhjes në pushtet, PS kishte ndjekur rrugën e PD të dhënies së koncesioneve me edhe më pak transparencë se që ishin bërë më parë<sup>53</sup>, përcjell me rreziqe për mjedisin dhe të kishin ngritur dyshime për korrupsion dhe lidhje ndërmjet kompanive konkurruese dhe përfaqësues politik në pushtet<sup>54</sup>. Por në Shqipëri, një shqetësim më i madh ngritët në lidhje me ligjet strategjike të hartuara posaçërisht për projekte specifike koncesionare, e që në përgjithësi nuk ishin iniciuar nga qeveria, por kishin ardhur me rekomandim të bizneseve si projekti për aeroportin e Vlorës, koncesioni i laboratorëve, industria e bixhozit dhe plani për Teatrin e Ri Kombëtar dhe kompleksin biznesor rreth tij në Tiranë<sup>55</sup>.

Problemet me kapjen e shtetit ishin identifikuar edhe në Mal të Zi<sup>56</sup>, me një theks në hartimin e ligjeve specifike për mbështetje të zhvillimit energjetik, planifikimit urbanistik e shpronësimeve. Ashtu si në gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, skema “Feed-in-Tariff” e garantimit të shitjes së energjisë së prodhuar, si një mjet stimulimi dhe garancie, kishte bërë investimet në hidro energji mjaft joshëse për investitorët në Mal të Zi. Por, hulmimet (MANS, 2015) kishin gjetur se bizneset që kishin përfituar nga këto investime (e që kishin ngjallur edhe reagime nga shoqëria për dëme mjedisore dhe shoqërore) ishin të ndërlidhura ngushtë me elitën politike përmes lidhjeve direkte familjare apo përmes udhëheqësve partiak. Një ndryshim i ligjit për planifikimin hapësinor dhe ndërtimin e objekteve (i

45 KDI: Neglizhenca kronike e qeverive 2014 – 2018 i kushton qytetarëve të Kosovës 53 milion euro, Press Conference, 2018 Dec 24  
 46 Sa kushton krijimi i një vendi të ri të punës?, 2016 Democracy 4 Development [D4D]  
 47 Lëvizja FOL kërkon transparencë për projektin e autostradës Morinë-Merdare, 2010; Lëvizja “Fol”: Parregullsi gjatë shpronësimit për autostradën Prishtinë-Gjilan-Dheu i Bardhë 2019  
 48 Vlera e kontratave: 108 milion euro / 22 km autostradë = 4.9 Milion Euro / për kilometër  
 49 “Rruga 6: Autostrada Prishtinë – Shkup”, 2015 Riinvest “Kosto mesatare për ndërtimin e 1km të autostradaës rreth 11.5 milion euro)  
 50 Rrjeti i kompanive të familjarëve të AAK-së, betonojnë autostradën Prishtinë – Gjilan, 01.2.2019 Kallxo.com  
 51 Konfirmohet aktakuza ndaj ish-sekretarit të MI-së, Betim Reçica dhe tre zyrtarëve të tjerë për dallavere në tenderin për autostradën e Gjilanit, 07.06.2021 Telegrafi  
 52 Partneritetet publiko private në Shqipëri, qasur më 7 dhjetor 2021 (http://ppp.reporter.al/)  
 53 Mënyra e gabuar për të dhënë një hidrocentral me koncesion, 8 janar 2016, Reporter.al  
 54 Një tjetër krim shkatërrues ndaj natyrës: hidrocentral në Theth. Dyshime për korrupsion, 13 shtator 2017, exit.al  
 55 Dekonstruktimi i kapjes së shtetit në Shqipëri, 2021 (Institute for Democracy and Mediation & Transparency International)  
 56 Kapja e shtetit: Raporti kombëtar për Malin e Zi, 2021 MANS





Projekti me interes strategjik kombëtar për ndërtimin e autostradës

## "Arbën Xhaferi"

u kishte kushtuar qytetarëve të Kosovës

## 53 milion euro

dëmshpërblim si pasojë e një kontrate jo të hartuar mirë dhe neglizhencës të tre qeverive në menaxhimin e detyrimeve. Detajet e dëmshpërblimit mbeten të mbyllura për publikun që nga viti 2018.



Në Shqipëri për 15 vite ishin dhënë

## 219 kontrata

koncesionare për investime strategjike ku rreth

## 87%

ishin për shfrytëzimin e burimeve natyrore me

## 95%

të tyre për HEC në vlerë të afër

## 3.2 miliard

Shumë nga këto investime ishin kundërshtuar nga qytetarët për ndikimet negative mjedisore.



Në projektin strategjik për ndërtimin e impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Budvë, Mal i Zi, përveç që ishin vjedhur

## 3 milion euro

në fatura fiktive, ishin humbur rreth

## 20 milion

të tjerë në fryrjen e çmimeve.

Ndërsa komuna rrezikon të humbas edhe

## miliona

të tjerë për shkak të kontesteve detyrimore projekti ishte ballafaquar me probleme të ndryshme, mes tyre edhe ndotje të mjedisit, si rezultat i cilësisë së punëve të dobëta.



Në Serbi, përveç që qytetarët kishin paguar mbi

## 450 milion €

në infrastrukturën ndihmëse (rrugë, gazsjellës, hekurudhë dhe shpronësime) në favor të investitorit në minierën e luginës së Jadarit, sipas planit të punës, përveç derdhjes së mbi 90 milion tonëve të mbetjeve sterile nga mihja në lum, ishte paraparë të bëhej një deponi ku mbi 7,000 ton arsenik do të derdhejshin në një afërsi të lumit, e që një devijim i saj dhe dalje në lum do të rrezikonte seriozisht shëndetin e qytetarëve të dy shteteve Serbisë dhe Bosnje dhe Hercegovinës.



Projekti Shkupi 2014 në Maqedoninë e Veriut që fillimisht ishte thënë se do të kushtonte rreth

## 80 milion €,

deri më tani kishte arritur vlerën e

## 560 milion €,

ndërsa për përfundimin e të gjitha objekteve të filluara dhe planifikuara kostoja parashihet të arrij në

## 1.3 bilion €.

Hulumtimet tregojnë se nga ky projekt përfituan njerëz të lidhur ngusht me me pushtetin e atëhershëm.



Hulumtimet në Bosnje dhe Hercegovinë ngrisin shqetësime se sipas kontratës koncesionare për autostradën autostradën Banja Luka Prijedor në Bosnje dhe Hercegovinë, kompania implementuese nga

## 297 milionë €

të investuara do të fitojnë

## 975 milionë €.

Po ashtu, sipas kontratës, qeveria duhet të kompenzoj kompaninë deri në

## 50 milion KM

në vit për të mbuluar dallimin ndërmjet qarkullimit real dhe të hyrave të parashikuara.



Qeveria e Turqisë për 13 vite kishte bërë 150 ndryshime të ligjit për prokurimin publik (përfshirë partneritetin publiko privat) ku deri në vitin 2014, shkalla e PPP-së kishte arritur në

## 88 miliardë

dollarë amerikanë me 167 projekte strategjike kombëtare. Një nga këto projekte ishte ura e tretë mbi Bosfor, që kishte kushtuar rreth

## 3 miliard

dollarë amerikanë dhe e inauguruar në vitin 2016, ka pasur një performancë të dobët në vazhdimësi duke mos arritur një kuotë të kënaqshme të shfrytëzimit, por që publiku vazhdoi të paguaj çmimin për këtë për shkak të garancive që qeveria kishte ofruar për kompanitë që drejtajnë projektin

kundërshtuar nga shoqëria civile) për të centralizuar vendimet lidhur me planet hapësinore, lejet dhe menaxhimin e tyre, i kishte krijuar mundësinë qeverisë të favorizonte biznese të caktuara, madje edhe për ndërtime të nivelit lokal, ku deri atëherë nuk kishin mundur të ndikojnë. Ndryshimi në ligjin për planifikimin hapësinor po ashtu kishte paraparë ndërtimin e hoteleve dhe resorteve luksoze si interes publik, e që me aprovimin e ligjit për shpronësim i jepte të drejtën shtetit të shpresonte pronat private edhe nëse nuk arrinin një marrëveshje me pronarët e tyre. Ky ligj hyri në fuqi pas disa përpjekjeve të qeverisë për të zhvilluar pjesët e mbetura të paprishura të bregdetit malazez, të cilat dështuan për shkak të një numri pronarësh privatë të cilët nuk ishin të gatshëm të shisnin tokën e tyre. Kjo ishte bërë në mënyrë që qasja në këto prona nga investitorët e mundshëm t'i ofrohej nga qeveria. Shembulli më i dukshëm është rasti i planeve të qeverisë për urbanizimin masiv të Gjirit të Buljaricës<sup>57</sup>. Një tjetër afërë e shfrytëzimit të "projektit strategjik për të mirën publike" ishte ai i ndërtimit të impiantit për trajtimin e ujërave të zeza në Budvë. Komuna e Budvës në vitin 2009 kishte nënshkruar një kontratë me kompaninë gjermane WTE të tipit DBFO (design-build-finance-operate për ndërtimin e tre impianteve të trajtimit të ujërave të zeza në Becici, Jaz dhe Buljarica, si dhe një sistem kanalizimi. Në Shën Stefan. Kapaciteti i përgjithshëm ishte për t'i shërbyer popullatës prej 130 mijë banorësh. Vlera e projektit ishte 58.56 milionë euro plus interesin dhe kostot variabile, me

kusht që investimi total të mos e kalojë kufirin e paraparë të tenderit prej 85 milionë euro. Kontrata parashikonte gjithashtu kosto vjetore të menaxhimit prej 1.7 milion € deri në vitin 2042, ndërsa Budva do të shlyente investimin deri në vitin 2034. Projekti u përfundua vetëm pjesërisht kur impianti i trajtimit të ujit në Becici filloi funksionimin e tij testues në korrik 2014. Ai u hap zyrtarisht në fillim tetorit 2014. Pas hapjes në këtë impiant filluan të shpërfaqen probleme nga më të ndryshmet, e me një theks në ndotjet mjedisore, që rezultoi si pasojë e punimeve të dobëta. Gjatë hetimit të rastit dhe analizimit të punëve dhe faturave të paguara sipas dokumenteve të trajtimit të rastit nga gjykata bëhet e ditur se në këtë projekt ishin vjedhur tre milion euro në fatura fiktive, dhe ishin humbur rreth 20 milion të tjerë në fryrjen e çmimeve, ndërsa komuna rrezikon të humbas edhe miliona të tjerë për shkak të kontesteve detyrimore<sup>58</sup>.

Në Serbi (Transparency International Serbia, 2021) ishin ngritur shqetësime të larta lidhur me ligjet e hartuara për interese të caktuara sektorit privat, e një theks i veçantë bie mbi korrupsionin në menaxhimin e pronave publike, planeve urbane dhe procesit të shpronësimit<sup>59</sup>. Në projektin për ndërtimin "Belgrade Waterfront" në emër të zhvillimit ekonomik dhe bërjen e Beogradit një atraksion turistik dhe biznesor, Qeveritë e nivelit lokal dhe qendror kishin nënshkruar disa kontrata "strategjike" me kompani specifike të shteteve që do të investonin në këtë projekt duke anashkaluar të gjitha

dispozitat ligjore të cilat obligojnë konkurrencën në prokurimin publik, dispozitat ligjore për partneritet publiko privat, ligjin për privatizim të pronave publike, dhe duke bërë ndryshime në planin urbanistik të Beogradit për t'u përshtatur investitorëve. Që nga fillimi i këtij projekti, qytetarët kishin protestuar kundër veprimeve të ndryshme lidhur me këtë zhvillim, por që brengat e tyre nuk kishin hasur në mbështetje të mekanizmave llogaridhënës. Madje, demolimi ilegal i disa objekteve në rrugën Hercegovacka, kishte rezultuar edhe në lëndimin dhe më pas vdekjen e një dëshmitari. Për më shumë, duke qenë se Beograd ka një nevojë të theksuar për ri strukturimin e transportit publik, në strategjinë e re për zhvillimin e metros ishte futur një elefant i bardhë, ku qeveria kishte deklaruar se do të fillonte të punonte sa më parë në linjën e re të metros nga Makis Field deri në Belgrade Waterfront, që të dy këto hapësira aktualisht nën ndërtim dhe të pa banuara, ndërsa strategjia linte jashtë mbulimit me rrjet nëntokësor të disa nga zonave më të frekuentuara nga qytetarët ku rregullimi i transportit publik është më se i nevojshëm. Për më shumë, të gjitha veprimet e qeverisë ishin përcjell me mungesë të transparencës duke e bërë të pamundur edhe për qytetarët dhe mediat që të jenë proaktiv në vendimmarrje.<sup>60</sup>

Projekti Shkupi 2014 që fillimisht ishte thënë se do të kushtonte rreth 80 milion Euro, deri më tani kishte arritur vlerën e 560

milion eurove, ndërsa për përfundimin e të gjitha objekteve të filluara dhe planifikuara kostoja parashihet të arrij në 1.3 bilion euro. Në ndërkohë, pas vitesh të tëra mungese të plotë të transparencës, sigurimi i disa nga kontratat për realizimin e këtij projekti shpërfaqin shqetësime serioze të përfitimeve nga kompani dhe individ të involvuar direkt apo lidhur ngusht me pushtetin e atëhershëm<sup>61</sup>. Loja me pronat publike duket të jetë një mjaft joshëse edhe në Maqedoninë e Veriut. Përderisa në ligjet e aprovuara më parë, pronat bujqësore publike nuk mund të shiteshin, në vitin 2021 Qeveria me nxitim kishte iniciuar ndryshime ligjore për t'ia rregulluar rrugën përfitimit të bizneseve private. Plani i qeverisë është që të shiten 10-15% e tokave bujqësore publike në një vlerë 200-300 milionë euro. Madhësia minimale e planifikuar është më pak se 10 hektarë tokë për blerës. Fillimisht plani është që të lejohen vetëm personat fizikë dhe juridikë vendas, por kompanitë lejohen të kenë kapital të huaj. Çmimi i planifikuar do të jetë 250-450 € për hektar, e përparësi do t'u jepet pronarëve me koncesion dhe nuk do të lejohet që toka të ripërcaktohet si parcelë ndërtimi. Një ligj tjetër që pritet të ndryshohet është ai mbi lejet e ndërtimit, e ku pritet që të gjitha pronat e ndërtuara pa leje dhe pa paguar taksat përkatëse do të lirohen nga penalizimet nëse ato janë të përfunduara në kohën e hyrjes në fuqi të ligjit të ri, kjo edhe për ato të ndërtuara në prona publike e brenda parqeve kombëtare<sup>62</sup>.

57 Ibid

58 [Dy arbitrazime ndërkombëtare shkojnë mbi ishinë e trajtimit të ujit në budvë mes akuzimit për ndotje dhe korrupsion: fatura të fryshme me miliona në të gjithshëm hetimi zhvillon përgjithmonë, 2021 Centar za istraživačko novinarstvo Crne Gore](#)

59 Korrupsioni i nivelit të lartë dhe ligjet e hartuara për interese private në Serbi, 2021 Transparency International Serbia.

60 "Assessing State capture in high risk sectors - urban planning example-" Transparency International Serbia presentation in the focusgroup 04-05 Shtator 2021, Albania

61 [Zbulohet kosto e vërtetë e "Shkupi 2014", 2015 BIRN](#)

62 Stojanovski A, Nikolovski D., 2021 The controversy of 'more (economic) freedom'. Can liberalisation in North Macedonia cause more problems than benefits?, WB2EU project

Sipas Transparency International BH<sup>63</sup>, Qeveria e Republikës Srbska (RS), Bosnje dhe Hercegovinë, i kishte dhënë një koncesion grupit kinez Shandong të shpejtësisë së lartë për të ndërtuar autostradën Banja Luka Prijedor. Kinezët do të jenë pronarë të autostradës për 30 vjet dhe RS, pa një analizë të trafikut të automjeteve, i garanoi kompanisë kineze se do të mblidhte 60 milionë KM (Konvertibilna Marka) tarifa në autostradë në vit dhe gjithnjë e më pak do të paguhen nga buxheti i RS. Sipas parashikimeve dhe tendencave aktuale në mbledhjen e të ardhurave, qeveria e RS do të duhet të kompensojë kompaninë kineze deri në 50 milionë KM në vit për autostradën Banja Luka-Prijedor. Presioni mbi financat publike do të jetë i madh duke marrë parasysh edhe shlyerjen e kredisë për dy autostradat e tjera. Për shkak të tendencave negative ekonomike (COVID 19), Republika Srpska rrezikon të bjerë në kurthin e borxhit dhe ta gjejë veten të paaftë për të përmbushur detyrimet e saj. Qeveria e RS aktualisht po e fsheh kontratën nga publiku në mënyrë që qytetarët të mos jenë ende të vetëdijshëm për të gjithë elementët e kontratës, përveç asaj që qeveria ka publikuar në media. Arsyeja pse projekti ishte jofitimprurës janë interesat private të kompanive të lidhura me autoritetet, të cilat duhet të zënë vende pune nga ndërtimi i asaj autostrade. Sipas asaj që u njoftua nga 297 milionë euro të investuara, vlerësohet se kompanitë kineze do të fitojnë 975 milionë euro. Kuadri ligjor aktual i jep qeverisë kompetenca të gjera në fushën e koncesioneve, për këtë arsye janë lidhur një sërë kontratash të dëmshme.

Në Turqi (Transparency International Turqia, 2020) analiza e ndryshimeve ligjore të bëra 2002 – 2015 kishte shpërfaqur shqetësime të ndryshme për ligje të hartuara në favor të bizneseve të afërta me qeverinë. Që nga ardhja e AKP-së<sup>64</sup> në pushtet (Gürakar, 2017) qeveria kishte bërë mbi 150 ndryshime në ligj të prokurimit publik, duke rihapur në thelb derën ndaj miqësisë dhe favorizimit të bizneseve të caktuara të lidhura me pushtetin aktual. Korrupsioni kishte prekur në thellësi procesin e privatizimit, nga i cili kishin përfituar kompanitë të cilat më tutje ishin shpërblyer me mega-projekte strategjike përmes partneritetit publiko privat, të cilat po ashtu përfitojnë nga kontratat më të mëdha përmes prokurimit publik. (Transparency International Turqia 2020) Përshkallëzimi i

privatizimit dhe PPP në Turqi filluar pas krizës së dyfishtë të vitit 2001. Në vitin 2014, shkalla e PPP-së kishte arritur në 88 miliardë dollarë amerikanë me 167 projekte. Praktika e PPP-ve ka kaluar përtej projekteve të mëdha tipike të infrastrukturës. Aktualisht modeli Build-Operate-Transfer (BOT) përdoret për ndërtimin e burgjeve private, aeroporteve kryesore, porteve, hidrocentraleve, energjisë bërthamore, digave, autostradave, spitaleve të qytetit, urave dhe tuneleve. Disa projekte madhore janë: Ura e 3-të e Bosforit, Aeroporti i 3-të i Stambollit, Ura Osman Gazi, Yavuz Sulltan Selim dhe Çanakkale, dhjetëra ndërtime hidrocentralesh, tunele Marmaray dhe Avrasya në Bosfor. Sipas Gürakar (2017) ura e tretë mbi Bosfor, një projekt që tatimpagueseve të Turqisë u kishte kushtuar rreth 3 miliard dollarë amerikan dhe e inauguruar në vitin 2016, ka pasur një performancë të dobët në vazhdimësi duke mos arritur një kuotë të kënaqshme të shfrytëzimit, por që publiku vazhdoj të paguaj çmimin për këtë për shkak të garancive që qeveria kishte ofruar për kompanitë që drejtojnë projektin. Akterët kryesorë që kanë përfituar nga këto investime janë Kolin, Limak, Cengiz, Çalık, ERG, Torunlar dhe Rönesans, të gjitha me lidhje të ngushta me elitën politike në Turqi. Për më shumë një shqetësim që rrjedh nga këto përfitime është korrupsioni politik, ku këto kompani një pjesë të fitimeve të tyre i dhurojnë në komunitet për të siguruar mbështetje të votueseve për qeverinë aktuale<sup>65</sup>.

Por këto kompani nuk kishin përfituar nga koncesionet e PPP vetëm në Turqi. Në vitin 2010 LIMAK kishte marr me koncesion aeroportin e Prishtinës (Kosovë)<sup>66</sup> ndërsa në konsorcium me Çalik kishin privatizuar rrejetin shpërndarës elektrik në Kosovë. Ndërkohë, në Shqipëri LIMAK kishte marr me koncesion ndërtimin e dy pendave (Banjë dhe Moglicë) dhe hidrocentraleve<sup>67</sup>, ndërsa në Maqedoninë e veriut, LIMAK kishte bërë investime të shumta në ndërtimin e objekteve rezidenciale dhe komerciale (Cevahir Sky City, Limak Holding, Koç)<sup>68</sup>. Në ndërkohë, Çalık Holding bleu BKT-në shqiptare (Banka Kombetare Tregtare) në vitin 2006, e cila ka degë në Shqipëri dhe Kosovë. Konsorciumi KOLIN-Juksel-Makwol kishte nënshkruar kontratën me Qeverinë e Serbisë për ndërtimin e një pjese të të autostradës (445 km) që shtrihet nga kryeqyteti serb (Beograd) në portin malazez të Barit, përmes rajonit të Sanxhakut<sup>69</sup>.

63 Prezantimi i rastit në punëtorinë e mbajtur me 04-05 stator 2021, Shqipëri  
 64 Adalet ve Kalkınma Partisi (AKP) – Patria për Drejtësi dhe Zhvillim (AKP)  
 65 Sfidat në qeverisje të mirë, 2021 Transparency International Turkey  
 66 Koncesionimi i aeroportit, 2015 RIINVEST Institute  
 67 Limak i Turqisë zgjeron projektet energjetike në Ballkan, 2016 AA Energy  
 68 Ndikimi i aktorëve të jashtëm në Ballkanin Perëndimor, 2018 Feyerabend, F., Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.  
 69 Ndikimi i Turqisë në Ballkanin Perëndimor, Bugajski, J., 2012 Atlantic Council

# KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET

## Në përgjigjen e tre pyetjeve të parashtruara në metodologji

- 1 Cilat investime kanë ndikimin më të madh në mjedis dhe shoqëri dhe humbje të parasë publike?,
- 2 A ka një bazë ligjore për të menaxhuar rrezikun nga këto investime?, dhe
- 3 Çfarë mund të bëhet që të përmirësohet kjo situatë?:

- Raporti na nxjerr të dhëna shqetësuese se ndikimet më të mëdha mjedisore dhe shoqërore rrjedhin nga investimet strategjike në dikasterin e energjisë së ripërtrishme, dhe se fatkeqësisht përveç ligjeve të hartuara për favore ndaj bizneseve të caktuara, për këto dëme apo edhe koston oportune nuk kishte një vlerësim të koston oportune paraprakisht, apo edhe tani pas shumë reagimeve nga qytetarët. Por në aspektin e ndotjes më të theksuar të lumenjve, në rajonin e Ballkanit perëndimor rezultojnë të jenë rrjetet e ujërave të zeza. Ndërsa projektet favorite për korrupsion dhe humje të mëdha të resurseve (të luajtshme dhe paluajtshme) publike janë projektet strategjike me rëndësi kombëtare por për përfitime marramendëse private.

- Analiza e ligjeve të shteteve të rajonit ka gjetur se, ndonëse nga trajtimi i situatave të më sipërme, rrjetet e ujërave të zeza rezultojnë të jenë ndotësi kryesor i lumenjve në Ballkanin Perëndimor, ligjet për vlerësimin e ndikimit në mjedis nuk parashohin që ky vlerësim të jetë i obligueshëm për këtë lloj investimi, dhe pastaj të krijohen kushtet për menaxhimin e rrezikut. Megjithatë, të gjitha shtetet posedojnë me legjislacionet adekuate për vlerësimin e ndikimit në mjedis sa i përket energjisë, infrastrukturës rrugore, dhe shumë

investimeve të tjera. Por këto vlerësime siç duket ishin të dështuara duke marr parasysh që ato kishin lejuar degradimet të ndodhnin, dhe që tërësisht kishin lënë jashtë përfshirjen e publikuat ashtu siç kërkohet ligjërisht. Këto anashkalime ligjore rezultojnë të jenë bërë në favor të bizneseve të caktuara, nën pretekstin e projekteve strategjike për përmbushjen e detyrimeve në rrugën drejt BE. Për më shumë, ndonëse ligjet përkatëse për obligimet detyimore mes palëve obligojnë implementimin e të gjitha kushteve të veçanta dhe kushteve të përgjithshme (që do të thotë implementimin e të gjitha ligjeve në fuqi) këto ligje duket të jenë pak i zbatueshëm në praktikë duke marr parasysh shkeljet e raportuara lidhur me kushtet ujore, kodet ndërtimore, etj. Ky ngjanë të jetë një problem edhe më i madh në rastet e ndërtimit të rrugëve dhe objekteve të ndryshme publike, ku prokurimi publik shërben si një urë për shkeljen e ligjeve tjera gjegjëse, dhe pastaj kualiteti i dobët i punëve i "atribuohet" çmimit më të lirë dhe jo përgjegjshmërisë. Raporti gjithashtu shpërfaq shqetësime se sa më e madhe të jetë vlera e investimeve, aq më shumë ulet përgjegjshmëria përmes aprovimit të ligjeve specifike për investimin në fjalë duke bërë kështu koncesionet një bankë të korrupsionit. Për më shumë, në këto projekte





publiku anashkalohet tërësisht duke u ballafaquar vetëm me pasojat por pa pasur mundësinë të ndikoj në parandalim.

- Duke parë se rreziku më i madh për korrupsion dhe ndikim negativ në mjedis dhe shoqëri bie mu në gamën e strategjisë për zhvillim të rajonit të mbështetur nga IPA III dhe Marrëveshja e Sofies, në një rajon ku drejtësia mbetet shtylla më e dobët në funksionalitetin shtetëror, me qëllim që fondet të shfrytëzohen në mënyrë sa më të drejtë dhe në të mirën e përgjithshme.

#### Rekomandojmë që:

- 1 Bashkimi Evropian të vendoste rregulla ndaj shteteve përkatëse për përfshirjen e qytetarëve në këto projekte përmes "Pakteve të Integritetit" të cilat janë një vegël e zhvilluar për monitorimin e një shkalle shumë më të lartë të shpenzimit të fondeve të BE në mënyrë sa më llogaridhënëse dhe transparente.
- 2 Sipas ligjeve përkatëse për obligimet detyimore, që një kontratë të jetë valide, duhen të respektohen të gjitha ligjet në fuqi. Shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqia duhet të angazhohen në identifikimin e të gjitha dispozitave ligjore të aplikueshme dhe duhet të angazhohen në krijimin e mekanizmave mbikëqyrës gjatë të të gjitha fazave të zhvillimit të projekteve që të sigurohen për përgjegjshmërinë institucionale dhe kontraktuale.

3 Shtetet e Ballkanit Perëndimorë dhe Turqia duhet të përafrohen sa më shumë me publikun, dhe të krijojnë komunikim të qëndrueshëm ndërmjet dy palëve, duke evituar kështu konfuzionin nga fshehtësia, pakënaqësitë ndaj investimeve dhe duke e bërë qytetarin pjesë integrale në zhvillim të shtetit por edhe në parandalim të rreziqeve apo mekanizëm ndihmues në llogaridhënie.

4 Shtetet e Ballkanit Perëndimor duhet që urgjentisht të trajtojnë problemin e ndotjes së lumenjve nga rrjetet e ujërave të zeza dhe të plotësojnë mangësitë ligjore në vlerësimin dhe menaxhimin e këtij investimi publik.



# FALENDËRIMET:

## Kontribues me materiale hulumtuese dhe raste specifike:



Transparency International:  
<https://www.transparency.org>



Transparency International Bosnia dhe Hercegovina -  
<https://ti-bih.org/?lang=en>



Transparency International Turkey -  
<https://en.seffalik.org/>



PAKT - Ekipi Kundër Korrupsionit në Podrinje -  
<https://pakt.org.rs/sr/>



Transparency International Serbia -  
<https://www.transparentnost.org.rs/index.php/en/>



## Pjesëmarrës në punëtori (04-05 shtator 2021, Shqipëri):

### Panelistët:

- **Gresa Smolica**, Cooperation and Development Institute, Albania, Tema: Integriteti i Investimeve Kapitale – keqmenaxhimi dhe rreziqet e korrupsionit në Ballkanin Perëndimor
- **Brice Bohmer**, Transparency International, Global Climate Integrity - Rreziqet mjedisore dhe impakti negativ në florë dhe faunë nga investimet kapitale të keqmenaxhuara dhe të paplanifikuara
- **Rafael Garcia Aceves**, Transparency International Secretariat (Public Contracting division), Tema: Paktet e Integritetit dhe dobitë e tyre

### Prezantues nga rajoni:

- **Florent Spahia**, Kosova Democratic Institute (KDI), Tema: Korrupsioni në investime kapitale dhe ndikimi në mirëqenie të qytetarëve (Kosovë)
- **Damjan Ozegovic**, TI Bosnia and Herzegovina, Tema: Ekspozimi ndaj rreziqeve që rrjedhin nga investimet kapitale publike (BiH)
- **Miroslav Mijatovic** – PAKT Loznica dhe në emër të Transparency International: Temat: (1) RIO-TIN-TO Serbia dhe (2) Vlerësimi i kapjes së shtetit në sektorët me rrezik të lartë: shembull i planifikimit urban (Serbia)
- **Yalın Hatipoğlu**, TI Turkey, Tema: Sfidat në qeverisje të mirë


### Kontribues në diskutim:

- **Hasim Sabotic**, Agency for the Prevention of Corruption and Coordination of the Fight against Corruption BiH
- **Enisa Hrbat**, Agency for the Prevention of Corruption and Coordination of the Fight against Corruption BiH
- **Srdjan Traljic**, TI Bosnia and Herzegovina
- **Frashër Murtezaj**, Agjencia Kundërkorrupsion, Kosovë
- **Driton Abdullahu**, Agjencia Kundërkorrupsion, Kosovë
- **Musli Iballi**, Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik, Kosovë
- **Osman Bytyçi**, Komisioni Rregullativ I Prokurimit Publik, Kosovë
- **Aranita Brahaj**, AIS/Open Data Albania
- **Agon Hysaj**, Democracy Plus, Kosovë
- **Nita Azemi**, Lëvizja FOL, Kosovë
- **Yllka Buzhala**, Lëvizja FOL, Kosovë
- **Blerina Kuçi**, Instituti i Gjellbër, Kosovë
- **Ismet Kryeziu**, Kosova Democratic Institute (KDI)
- **Violeta Haxholli**, Kosova Democratic Institute (KDI)



Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës



ISBN





KDI është Organizatë Joqeveritare (OJQ) e angazhuar të mbështesë zhvillimin e demokracisë përmes përfshirjes së qytetarëve në bërjen e politikave publike dhe fuqizimin e sektorit të shoqërisë civile me synimin për të ndikuar në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve publike.

Për më shumë informata rreth KDI ju lutem vizitoni [www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)

Me përkrahjen financiare të:

